



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:278206

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06892909

P.nr.291/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit S.M. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1124/23 e datës 07.10.2024, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 20.02.2025, në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit Shaqir Sedolli, e dëmtuara N.M., i pandehuri S.M., mbrojtësi sipas autorizimit av.Abit Asllani dhe mbrojtësi i viktimave Ensar Suma, më datën 20.02.2025 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 24.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: S.M. nga i ati M..., e ëma Z..., e gjinisë T..., data e lindjes... në fshatin D..., tani me vendbanim në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, punon në treg me barna bio, i martuar, prind i shtatë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 22.07.2023 rreth orës 22:00 minuta, në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, saktësisht në shtëpinë e përbashkët, me dashje përdorë forcën ndaj të dëmtuarës viktimës së ndjeshme-bashkëshortes N.M., si pasojë e mosmarrëveshjes të atëçastshme lidhur me kohën që e dëmtuara ishte kthyer vonë në shtëpi nga e pamja që kishte qenë tek hallat e saj, i pandehuri në shenjë revolte ngritët në këmbë dhe e godet me grusht në kokë, nga e cila goditje e dëmtuara detyrohet të marr tretman mjekësor dhe hospitalizohet,

- Me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 44, 46, 47, 69, 70,

184 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 460 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurit S.M.: i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar ne DËNIM ME GJOBË në shumën prej njëmijë e dyqind (1200) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguaj këtë dënim me gjobë ose nuk mundet atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo 20 euro (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1 (një) ditë burgim.

Pala e dëmtuar N.M. ka hequr dorë nga kërkesa për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsjetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1124/23 e datës 07.10.2024, kundër të pandehurit S.M. nga fshati ..., komuna e Vushtrisë, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 26.11.2024, ku prezent kanë qenë prokurori i shtetit si dhe i pandehuri, ku në atë seancë gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij në këtë çështje penale si dhe pasi që është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë.

I pandehuri S.M. ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë.

Gjykata, pasi që i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, e ka njoftuar të pandehurin se jo më vonë se 30 ditë nga shqyrtimi fillestar ka të drejtë të paraqes kundërshtimet e tyre për provat e cekura ne aktakuzë, të paraqesë kërkesat për hedhjen e aktakuzës nëse është e ndaluar ligjërisht dhe të paraqesë kërkesën për hudhjen e aktakuzës për shkak të mos përshkrimit të veprës penale.

Pasi që i njëjti nuk e ka ushtruar të drejtën e tij për të paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtim të provave brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.02.2025

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më datë 20.02.2025, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri S.M. ka deklaruar se e pranon fajësinë dhe ne te njëjtën kohe ka deklaruar se është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen kjo veprë nuk do të përsëritet më, tanimë raportet me të dëmtuarën janë të mira dhe se në të ardhmen do të jetë shumë i kujdesshëm për ruajtjen e familjes dhe mirëqenies së fëmijëve të tyre, e po ashtu të njëjtës i ka kërkuar falje edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi që ky deklaram i tij gjen mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe është bërë pas konsultimit paraprak me mbrojtësin e tij.

Mbrojtësi i viktimave lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e mbështet fjalën e prokurorit të shtetit dhe i propozojnë gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë së të pandehurit.

Pala e dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri, kanë raporte të mira pas veprave të kryera, i njëjti kujdeset për mirëqenien e fëmijëve, dhe meqenëse janë pajtuar me të i kërkon gjykatës të i shqiptoj një dënim sa më të butë dhe njëherit heq dorë nga kërkesa pasurore juridike lidhur me këtë çështje.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit numër të rastit 2023-BD-610, i datës 22.07.2023, raporti ditor i dhunës në familje, i datës 22.07.2023, urdhër për mbrojtjen e përkohshme emergjente, i datës 22.07.2023, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin S.M., i datës 23.07.2023, procesverbali i marrjes në pyetje i të dëmtuarës, i datës 23.07.2023.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.1 e lidhur me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 184 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Sulmi e kryen “Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim

deri në një (1) vit.”. Ndërsa në par.3 nën par.3.1 është përcaktuar se “Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi dënohet me: burgim deri në tre (3) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Sulmi nga neni 184 par.3 nën par.3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, kërkim faljen që i'a ka bërë të dëmtuarës dhe se tani më janë pajtuar me të njëjtën dhe se kanë 7 fëmijë të përbashkët ku dhe i njëjti kujdeset për shëndetin e bashkëshortes dhe fëmijëve të tyre, ndërsa si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e rrezikshmërisë shoqërore që paraqet kjo vepër penale, faktin se kjo vepër penale është kryer brenda marrëdhënies familjare dhe vetë ligji e parashih si rrethanë rënduese, po ashtu si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur respektivisht viktima është e ndjeshme, posaçërisht e pa mbrojtur, si dhe shkallën e lartë të dashjes në drejtim të kryerjes së kësaj vepre penale

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burg në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e dyqind (1200) euro, me rastin e shpalljes së aktgjykimit i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës se dëmtuar në kontest të rregullt civil gjykata e ka marrë në bazë të nenit 460 të KPPK-së, pasi që pala e dëmtuar ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2

nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.291/2024, datë 24.02.2025

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.